

**V E N D I M**  
**Nr. 562, datë 23.10.2000**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.479, DATË 31.8.2000, TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS  
SË KONCESIONIT, PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE, NË  
AEROPORTIN E RINASIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.7073, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të neneve 21 dhe 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe të neneve 5 dhe 17, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.479, datë 31.8.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për përgatitjen dhe realizimin e kontratës së koncesionit, për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve, në Aeroportin e Rinasit”, pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

2. Pas pikës 4 të vendimit shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“Fondi prej 43 500 000 lekësh të përballohet nga fitimi i pritshëm për vitin 2000 i “Albtransport” sh.a.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**